

Ekskluzive

Ekskluzive | Nga rasti i ngacmimit seksual të 17-vjeçares te armët dhe 224 fishekët – ky është pronari i “BK Models” që përfundoi në pranga



Sinjali.com

16 Gusht 2026 17:28



Detaje të reja kanë dalë në dritë nga rasti që nisi me dyshimet për ngacmimin seksual të një 17-vjeçareje në Prishtinë, e që tashmë është zgjeruar edhe në hetime për manipulim me prova dhe armëmbajtje pa autorizim, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se personi i dyshuar është **Blodin Karaxha 36-vjeçar** pronar i “BK Models SHPK”, i cili me vendim të Prokurorit të Shtetit është ndaluar për 48 orë.

Gjithçka kishte nisur më 4 gusht, kur ndaj Karaxhës ishte iniciuar rast nën dyshimin se në lokalin e tij në Dardani kishte ngacmuar seksualisht një të mitur 17-vjeçare, duke e prekur fizikisht në pjesë intime të trupit.

Por, hetimet për këtë rast kanë nxjerrë dyshime të tjera serioze.

Sipas informacioneve që ka mësuar Sinjali, hetuesit dyshojnë se po atë ditë, rreth orës 16:50, Karaxha e kishte hequr pajisjen DVR nga lokali, me dyshimin se këtë e kishte bërë për të zhdukur pamjet e kamerave të sigurisë që lidheshin me rastin e 17-vjeçares.

Më 15 gusht, gjatë vazhdimit të veprimeve hetimore, Karaxha është ndaluar sërish, ndërsa në koordinim me Prokurorin kujdestar janë kryer bastisje në shtëpinë dhe lokalin e tij.

Aty hetuesit kanë hasur në dy pistoleta. Për njërën, sipas të dhënave të rastit, leja kishte skaduar në janar të vitit 2025, ndërsa arma tjetër rezultonte pa leje.

Por gjatë kontrollit nuk janë gjetur vetëm armët.

Policia ka sekuestruar edhe 224 fishekë të kalibrit 7.65 mm, gjashtë fishekë me gaz, si dhe një palë pranga me çelës.

Pas këtyre gjetjeve dhe dyshimeve për DVR-në, me udhëzim të Prokurorit ndaj Karaxhës janë iniciuar edhe dy raste të tjera, për “Manipulim me prova” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, Blodin Karaxha është ndaluar për 48 orë, ndërsa hetimet për rastin po vazhdojnë.

**Lexo edhe**

Ekskluzive | Dyshohet se ngacmoi seksualisht 17-vjeçaren dhe hoqi DVR-në për të zhdukur provat – bastiset pronari i “BK Models”



Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.

**Lajme**

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera